

Ballkani Perëndimor RReE #17

KOSOVA

- Ekonomia e Kosovës parashihej të rritej me rreth 4 për qind në vitin 2020; mirëpo, për shkak të shpërthimit të COVID-19, ekonomia tani pritet të pësojë një rënie prej 4.5 për qind përkrah uljes së eksporteve të shërbimeve dhe të investimeve publike e private.
- Nëse shpërthimi i pandemisë zgjat dhe masat frenuese mbeten në fuqi deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2020, atëherë edhe recesioni do të jetë më i gjatë, e humbja e të hyrave buxhetore më e lartë, duke i kufizuar kështu mundësitë e reagimit të mëtejshëm me anë të politikave.
- Qeveria ka shpallur një pako stimuluese në vlerë prej 2.8 për qind të PBB-së për të mbështetur qytetarët, bizneset dhe profesionet e prekura. Shënjestimi i duhur kësaj pakoje [për ata që kanë më së shumti nevojë] është jetik për zbutjen e ndikimit të krizës në ekonomi, varfëri e shoqëri.

Zhvillimet e fundit ekonomike

Ekonomia vazhdoi të rritej me 4.2 për qind më 2019, por shpërthimi i COVID-19 do ta ndërpresë hovin e rritjes.¹ Shtytës kryesorë të rritjes [më 2019] ishin konsumi dhe eksportet e shërbimeve, kryesisht në shërbime të ofruara për diasporën kosovare. Konsumi privat i shtoi rritjes 1.8 pikë përqindjeje (pp), i mbështetur nga zgjerimi dyshifror i kredive, si dhe nga remitancat dhe punësimi më i lartë. Konsumi qeveritar shtoi edhe 0.5 pp. Eksportet në përgjithësi i shtuan rritjes 3.9 pikë përqindjeje falë riaktivizimit të Ferronikelit dhe rritjes solide të eksporteve të shërbimeve nga turizmi i diasporës. Investimet, në përgjithësi, kontribuuan në rritje me 1.3 pp, të nxitura nga huadhënia dhe investimet më të larta private në sektorin e ndërtimitarisë; ndërkaq, investimet publike mbetën në nivel me vitin paraprak në terma nominalë. Nga ana e prodhimit, shërbimet—kryesisht ato tregtare dhe financiare—ishtin motori kryesor i rritjes, pasuar nga rritja e aktivitetit industrial. Për të dytin vit radhazi sektori bujqësor shënoi rënie, duke kufizuar kështu rritjen e përgjithshme të ekonomisë.

Treguesit e tregut të punës u përmirësuan më 2019, por sërish mbeten të dobët krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Shkalla e punësimit u rrit mesatarisht me 1.3 pp në vitin 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, por është akoma më e ulëta në rajon. Papunësia ra për 3.9 pp, meqë më shumë qytetarë

gjetën vende pune, por pjesëmarrja në fuqinë punëtore ra për 0.4 pp, dhe mbetet ende e ulët në një mesatare prej 40.5 për qind. Kështu, gjersa Kosova po hyn në krizën e COVID-19, 70 për qind e popullsisë në moshë pune nuk janë të punësuar.

Pasi që Kosova e përfundoi vitin 2019 me depozita më të larta qeveritare dhe me borxh relativisht të ulët publik, ajo ka ca hapësire fiskale për të zbutur efektet e pandemisë, megjithëse kjo hapësirë është e kufizuar nga rritja e njëkohshme e shpenzimeve rrjedhëse. Në fund të vitit 2019, Kosova kishte një deficit prej 2.8 për qind të PBB-së, apo 0.3 për qind të PBB-së sipas deficitit të rregullës fiskale.² Të hyrat u rritën me 7.5 për qind të shtyra nga rritja e fuqishme dhe arkëtimi më i lartë i borxheve tatimore; shpenzimet u rritën me 7.4 për qind kundrejt rritjes së shpenzimeve rrjedhëse. Shpenzimet kapitale u rritën me vetëm 0.2 për qind, me nën-shpenzim të theksuar tek projektet e financuara nga borxhi i jashtëm. Si rezultat, depozitat qeveritare në para të gatshme u rritën me 0.5 pp, në 5.2 për qind të PBB-së (€367 milionë). Borxhi publik dhe garancionet mbeten në nivel të ulët prej 17.6 për qind të PBB-së.

Performanca e sektorit financiar e mbështeti rritjen në vitin 2019, por shpërthimi i COVID-19 do të ushtrojë presion në këtë sektor. Duke vazhduar hovin e vitit 2018, kreditë bankare për korporatat u rritën me 9.8 për qind, dhe kreditë

¹ Statistikat e rritjes bazohen në shifrat tremujore të PBB-së; Agjencia e Statistikave të Kosovës do të shpallë vlerësimet vjetore të PBB-së në shtator.

² Përkufizimi i rregullës fiskale përjashton shpenzimet kapitale të financuara nga të ardhurat e

privatizimit dhe kreditë nga projektet e financuara që nga 2015 nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Ballkani Perëndimor RReE #17

për ekonomitë shtëpiake u rritën me 10.4 për qind. Në dhjetor 2019, kreditë jo-performuese përbënin 2 për qind të gjithsej kredive. Normat mesatare efektive të interesit për kredi të reja u ulën paksa, nga 6.6 në 6.5 për qind, ndërsa normat e kredive për ekonomitë shtëpiake shënuan rënie më të theksuar, nga 7.2 në 6.8 për qind. Në sektorin bankar, rritja prej 16 për qind e depozitave tejkaloi rritjen prej 10 për qind të kredive. Mjaftueshmëria e kapitalit prej 15.9 për qind në fund të vitit të kaluar ishte mbi minimumin rregullator, dhe stres-testet tregojnë se sektori është i qëndrueshëm edhe ndaj goditjeve më serioze.

Inflacioni i çmimeve të konsumit u stabilizua në gjysmën e dytë të vitit 2019, duke rezultuar në një mesatare v-m-v prej 2.7 për qind në vit. Në vitin 2019, inflacioni ishte mesatarisht 2.7 për qind, i shtytur nga rritja e çmimeve të ushqimit, duhanit dhe lëndës djegëse, kryesisht si efekt i bartur nga rritja e çmimeve në tremujorin e parë.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse (DLLRR) u përmirësua në vitin 2019, meqë rritja e importit u ngadalësua dhe eksportet u rritën; por bilanci i jashtëm është i ndjeshëm ndaj ndryshimit të eksporteve të shërbimeve të shtyra nga diaspora, nga remitancat, dhe investimet e huaja direkte. Deficiti i llogarisë rrjedhëse ra nga 7.6 për qind e PBB-së në 2018 në 5.5 për qind. Në fund të vitit [2019], mbulimi me rezerva u rrit nga 3.5 muaj të importeve sa ishte më 2018, në 3.6 muaj. Rritja e importit të mallrave u ngadalësua nga 9.6 për qind më 2018 në 3.8 për qind, meqë projektet e mëdha të infrastrukturës publike u përfunduan në fillim të vitit 2019. Eksportet e mallrave u rritën me 4.4 për qind v-m-v dhe eksportet e shërbimeve me 7.3 për qind. Pjesa e eksporteve të shërbimeve, kryesisht për vizita të diasporës, u rrit në 23.4 për qind të PBB-së. Neto IHD-të mbetën të ulëta në 2.8 për qind të PBB-së, të përqendruara kryesisht në blerjen e patundshmërive nga kosovarët jo-rezidentë. Remitencat vazhduan të jenë burimi kryesor i financimit për deficitin e jashtëm, duke u rritur me 7.9 për qind, e duke arritur pjesëmarrje prej rreth 11.5 për qind të PBB-së.

Parashikimi

Në vitin 2020, shpërthimi i COVID-19 do të jetë barrë për ekonominë e Kosovës. Ndikimi i shpërthimit të COVID-19 do të transmetohet si nëpërmjet kanaleve të jashtme ashtu edhe nëpërmjet një kërkese më të ulët të brendshme. Skenari bazë i parashikimit që diskutohet më poshtë supozon se pandemia prek vetëm tremujorin e dytë, dhe aktiviteti ekonomik fillon e gjallërohet në gjysmëvjetorin e dytë; ndërsa skenari më pesimist supozon se masat frenuese nuk hiqen plotësisht deri në gusht, dhe rimëkëmbja fillon vetëm në tremujorin e katërt.

Në skenarin bazë, ekonomia parashikohet të tkurret me 4.5 përqind gjatë vitit 2020, me rikthim të rritjes në vitin 2021, ashtu si në pjesën tjetër të rajonit dhe botës. Para pandemisë, Kosova pritej të shënojë rritje të fortë prej 4 për qind. Mirëpo, pandemia dhe masat frenuese lidhur me të pritet të shkaktojnë tkurrje prej 4.5 për qind (Tabela 1). Eksportet e shërbimeve përbëjnë rreth 23.7 për qind të PBB-së, nga të cilat 80 për qind lidhen me udhëtimet [vizitat] nga diaspora në Kosovë. Duke supozuar një rënie prej 60 për qind të eksportit të shërbimeve v-m-v në tremujorin e dytë, kjo përktthehet në një rënie vjetore prej 11 për qind nga viti i kaluar. Eksportet në tërësi pritet të zbresin nga rritja e përgjithshme 3.4 pp, jo vetëm për shkak të eksporteve më të ulëta të shërbimeve, por edhe për shkak të rënies së parashikuar të çmimeve të nikelit. Investimet private, në anën tjetër, pritet të ulen nga pasiguria dhe kufizimet në likuiditet me të cilat përballen ndërmarrjet si rezultat i masave frenuese, e po ashtu edhe nga rënia e IHD-ve në sektorin e patundshmërisë. Konsumi privat parashihet të ulet me vetëm 0.2 për qind, por konsumi qeveritar pritet të rritet ndjeshëm bazuar në projeksionet buxhetore, por edhe për shkak të përgjigjes së nevojshme ndaj COVID-19. Investimet publike të financuara nga buxheti me gjasë do të ulen për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale për t'iu përgjigjur pandemisë. Disa projekte të mëdha të investimeve publike që pritej të përparojnë, veçanërisht projektet hekurudhore dhe rrugore të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, po ashtu

Ballkani Perëndimor RReE #17

mund të vonohen. Rritja pritët të rikthehet në vitin 2021, pas tkurrjes së vitit 2020.

Tabela 1: Parashikimi për Kosovën 2020

	Para-covid	Skenari Bazë	Skenari i padëshirueshëm
PBB reale	4.1	-4.5	-11.3
Konsumi real	3.2	1.1	-0.6
Investimet reale	3.8	-21.5	-28.5
Eksportet reale	4.0	-12.2	-25.5
Importet reale	2.2	-6.8	-8.0
Bilanci fiskal	-2.5	-6.3	-6.6
Borxhi PGP/PBB	17.6	22.5	24.9

Humbja potencialisht e lartë e të hyrave buxhetore, e kombinuar me pakon stimuluese fiskale, pritët të zgjerojë deficitin buxhetor në vitin 2020. Të hyrat buxhetore parashikohet të pësojnë rënie prej 11 për qind për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik dhe shtyrjes së detyrimit për pagesën e tatimeve të shpallur nga qeveria. Deficiti fiskal vlerësohet të arrijë në 6.3 për qind të PBB-së, përkundër një rënie së pritët prej 43.5 për qind të shpenzimeve kapitale, e shtyrë si nga rënia e të hyrave ashtu edhe nga pakoja stimuluese qeveritare, e cila vlerësohet se do të kushtojë rreth 2.8 për qind të PBB-së.

Nëse masat frenuese vazhdojnë në tremujorin e tretë, Kosova mund të bjerë në një recesion më të thellë. Në një skenar më pesimist, eksportet pritët të bien në terma realë me 25.5 për qind, kryesisht për shkak të rënies së thellë nominale të eksporteve të shërbimeve (25.9 për qind) dhe mallrave (18.6 për qind). Neto IHD-të pritët të ulen me -8.3 për qind, si për shkak të nivelit më të ulët të flukseve hyrëse në patundshmëri, ashtu edhe për shkak të rënies së ri-investimit për shkak të fitimeve më të ulëta. Investimet, si publike ashtu edhe private, pritët të pësojnë nga pasiguria, kufizimet në financim, si dhe nga hapësira e kufizuar fiskale. Konsumi privat gjithashtu pritët të ulë rritjen, përkrah uljes së punësimit dhe të ardhurave të disponueshme. Remitancat që vijnë nëpërmjet kanaleve joformale dhe IHD-të pritët të zvogëlohen, duke e bërë më të vështirë financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Megjithatë, duke pasur parasysh opsionet e

kufizuara të financimit, supozohet se çdo humbje e mëtutjeshme e të hyrave buxhetore do të kompensohet duke reduktuar pjesërisht shpenzimet kapitale dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime, e duke rritur kështu deficitin fiskal në 6.6 për qind.


Qeveria në detyrë ka shpallur pakon stimuluese për të zbutur ndikimin e epidemisë ekonomi dhe varfëri. Kjo pako përfshin rritje të përkohshme të përfitimeve të asistencës sociale dhe pensioneve që janë më pak se €100 në muaj, si dhe pagesë të veçantë për punonjësit që humbën vendet e punës për shkak të shpërthimit të pandemisë. Pakoja gjithashtu përfshin masa afatshkurtra dhe afatmesme për të mbështetur firmat private që preken nga epidemia, përfshirë edhe përmes subvencionimit të pagave. Kostoja e pakos vlerësohet në €190 milionë, rreth 2.8 për qind e PBB-së. Sidoqoftë, zgjatja e situatës së pandemisë do të rritë koston e pakos. Për të adresuar kufizimet e hapësirës fiskale, qeveria po negocion financim koncesionar shtesë me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateral dhe multilateral. Në prill, qeveria mori €51.6 milionë nga Instrumenti i Financimit të Shpejtë (RFI) të FMN-së. Bashkimi Evropian ka hapur mundësinë e një dritareje të re për asistencë makro-financiare për vendet partnere që nuk janë anëtare të BE-së, përfshirë edhe Kosovën. Kosova gjithashtu po finalizon me Bankën Botërore operacionin emergjent për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale dhe po diskuton mbështetje buxhetore për të lehtësuar nevojat e financimit. Për më tepër, Banka Qendrore ka udhëzuar që pagesat e kësteve të kredive të shtyhen për firmat dhe familjet e prekura. Duke pasur parasysh kornizën e kufizuar fiskale, duhet të vlerësohet me kujdes kostoja, financimi dhe zbatimi me shënjestrim i masave për të rritur efektivitetin e pakos stimuluese. Për Kosovën, politika fiskale është posqërisht e rëndësishme për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike, pasi që i mungojnë opsionet e politikës monetare. Racionalizimi i shpenzimeve publike jo-thelbësore mund të jetë i nevojshëm në mënyrë që të mund të përballohet pakoja e shpallur dhe kostoja shtesë e programit të asistencës sociale në të ardhmen.

Ballkani Perëndimor RRe #17

Avancimi i reformave strukturore në periudhën afatmesme do të jetë i nevojshëm për ta kompenzuar ndikimin negativ ekonomik të pandemisë dhe për t'i ndihmuar qytetarët që të rikuperohen më shpejt nga tronditjet ekonomike negative në të ardhmen.


Epidemia ka vërtetuar rëndësinë e mekanizmave të mbrojtjes sociale që funksionojnë mirë dhe që mund të identifikojnë dhe të mbështesin grupet e cenuara nga tronditjet e pafavorshme ekonomike, duke ruajtur rezervat fiskale. Zbatimi më i mirë i shpenzimeve të mbrojtjes sociale me shënjestrim për më të varfrit është vendimtar për uljen më të shpejtë të varfërisë, dhe si dhe për të shërbyer si stabilizues automatik për parandalimin e rënies e shpejtë të konsumit. Për të mbajtur nivele të larta dhe gjithëpërfshirëse të rritjes, është gjithashtu e nevojshme që Kosova t'i japë shtytje produktivitetit duke reduktuar barrën administrative për ndërmarrjet, p.sh., duke koordinuar më mirë inspektimet e bizneseve, duke investuar në kapitalin njerëzor dhe duke përmirësuar sundimin e ligjit në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet dhe qytetarët të trajtohen me korrektësi dhe barazi.

Përhapja e Covid19 do të shkaktojë tkurrje në vitin 2020.
(Kontributet në rritje, në përqindje)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Botërore.

Shpërthimi i zgjatur mund të thellojë tkurrjen, megjithëse pritet rimëkëmbje e ndjeshme në 2021.



Burimi: Kalkulimet dhe parashikimet e personelit të Bankës Botërore.

Deficitet fiskale do të zgjerohen për shkak të rënies së thellw të të hyrave.
(në përqindje të PBB-së)



Burimet: Ministria e Financave dhe Banka Botërore.


Inflacioni i çmimeve të konsumit filloi të zbutet në gjysmën e dytë të 2019.

(Inflacioni i IÇK-së, në përqindje)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Punësimi u rrit në vitin 2019, por mund të preket rëndë nga shpërthimi i Covid19
(Punësimi total)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketat e Fuqisë Punëtore.

Zgjerimi dyshifror i kreditimit mbështeti rritjen në vitin 2019
(Rritja e kreditimit, në përqindje)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

KOSOVA—Treguesit e përzgjedhur ekonomikë

KOSOVA	2014	2015	2016	2017	2018	2019 ^e	2020 ^f	2021 ^f
Rritja e PBB-së reale (në përqindje)	1.2	4.1	4.1	4.2	3.8	4.2	-4.5	5.2
<i>Kontributi (pikë përqindjeje):</i>								
Konsumi	3.8	2.5	4.7	1.5	5.4	2.3	1.2	3.0
Investimet	-1.4	2.9	2.1	1.5	2.1	1.7	-6.1	3.1
Eksportet neto	-1.2	-1.3	-2.7	1.2	-3.8	0.2	0.4	-0.8
Eksportet	2.9	0.5	0.5	4.0	1.0	2.8	-3.4	1.8
Importet (-)	4.1	1.8	3.2	2.8	4.8	2.5	-3.8	2.6
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatarja e periudhës)	0.4	-0.5	0.3	1.5	1.1	2.7	1.6	1.8
Të hyrat publike (në përqindje të PBB-së)	24.0	25.1	26.3	26.4	26.1	26.7	24.4	26.1
Shpenzimet publike (në përqindje të PBB-së)	26.6	27.1	27.7	27.6	29.0	29.5	30.7	30.5
<i>Prej të cilave:</i>								
Shpenzime për paga	8.7	9.0	9.0	8.6	8.8	8.7	9.4	8.9
Përfitime sociale	5.0	5.4	6.1	6.1	6.1	6.3	7.1	6.3
Shpenzime kapitale	7.4	7.0	7.2	7.3	7.9	7.5	4.4	7.8
Bilanci fiskal (në përqindje të PBB-së)	-2.6	-2.0	-1.4	-1.2	-3.0	-2.9	-6.3	-4.4
Bilanci primar fiskal (në përqindje të PBB-së)	-2.4	-1.7	-1.1	-0.9	-2.7	-2.5	-5.8	-3.9
Borxhi publik (në përqindje të PBB-së)	10.4	12.7	14.1	15.6	16.3	17.0	22.5	23.3
Borxhi publik dhe i garantuar publik (në përqindje të PBB-së)	10.6	12.8	14.4	16.3	16.9	17.6	23.1	23.9
<i>Prej të cilit: I jashtëm</i>								
Eksportet e mallrave (në përqindje të PBB-së)	5.8	5.5	5.1	5.9	5.6	5.6	5.0	5.0
Importet e mallrave (në përqindje të PBB-së)	42.7	41.9	42.8	44.3	46.3	45.7	45.8	43.5
Eksportet neto të shërbimeve (në përqindje të PBB-së)	8.3	7.9	10.5	12.9	12.7	13.2	13.3	11.5
Bilanci tregtar (në përqindje të PBB-së)	-28.7	-28.4	-27.2	-25.5	-28.0	-26.9	-27.5	-27.0
Fluksi hyrës i remitancave (në përqindje të PBB-së)	9.9	10.5	10.5	11.1	11.3	12.0	11.6	12.3
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në përqindje të PBB-së)	-6.9	-8.6	-7.9	-5.4	-7.6	-5.5	-7.2	-6.7
Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (në përqindje të PBB-së)	2.2	4.7	2.9	3.3	3.4	2.8	2.9	3.4
Borxhi i jashtëm (në përqindje të PBB-së)	31.2	33.3	33.2	32.6	30.3	30.4	34.0	32.8
Rritja reale e kreditimit privat (në përqindje, mesatarja e periudhës)	3.3	7.8	8.7	8.8	10.1	7.8	n.a.	n.a.
Kreditë jo-performuese (në përqindje të totalit të kredive, fundi i periudhës)	8.3	6.2	4.9	3.1	2.5	2.0	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë (në përqindje, mesatarja e periudhës)	35.3	32.9	27.5	30.5	29.5	25.7	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë së të rinjve (në përqindje, mesatarja e periudhës)	61.0	57.7	52.4	52.7	55.4	49.4	n.a.	n.a.
Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatarja e periudhës)	41.6	37.6	38.7	42.8	40.9	40.5	n.a.	n.a.
PBB për frymë (US\$)	4,061	3,577	3,698	3,956	4,423	4,409	4,318	4,615
Norma e varfërisë në kufirin US\$5/ditë, PPP (në përqindje të popullsisë)	25.3	21.4	20.7	21.6	19.8	17.9	18.7	16.9

Burimet: Autoritetet kombëtare, vlerësimet dhe parashikimet e Bankës Botërore.